



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
SENATI AKADEMIK

Nr. 335/2 Prot

Durrës, më: 04.02.2026

V E N D I M

Nr. 09, datë 04.02.2026

PËR

**"MIRATIMIN E FORMATIT TË DIPLOMËS PËR PROGRAMIN E STUDIMIT
MASTER I SHKENCAVE NË "QUANTUM INFORMATION TECHNOLOGY", TË
FAKULTETIT TË TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT, UNIVERSITETI
"ALEKSANDËR MOISIU", Durrës"**

Bazuar në ligjin, Nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë"; të ligjit Nr. 8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike"; në Udhëzimin Nr.10, datë 30.02.2020 "Për përcaktimin e elementëve përbërës, formën e diplomës ose certifikatës të lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë dhe procedurës së regjistrimit të tyre në regjistrin shtetëror të diplomave dhe certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor" i ndryshuar me Udhëzimin Nr.14, datë 21.06.2022 dhe Udhëzimin Nr.19, datë 31.08.2023; bazuar në Urdhërin Nr. 448, datë 14.08.2023 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit për hapjen e programit të studimit; në Statutin dhe në Rregulloren e UAMD-së; si dhe në relacionin e Drejtorisë së Kurrikulës, Cilësisë dhe Statistikave me Nr. 142 prot., datë 16.01.2026, në mbledhjen e datës 04.02.2026, Senati Akademik,

V E N D O S I:

1. Miratimin e formatit të diplomës për programin e studimit të ciklit të dytë, Master i Shkencave në "Quantum Information Technology", të Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit, Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen:
 - Administratori
 - Zv. Rektorët
 - Drejtuesi i Njesisë Kryesore, Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit
 - Drejtoria e Kurrikulës, Cilësisë dhe Statistikave
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R

Prof. Dr. Shkëlqim FORTUZI

